




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.507/2022
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M


- I. Refuzohet kërkesa për transfer e z. Arbër Beqiri, bashkëpunëtor profesionale që të transferohet nga Gjykata Themelore Mitrovicë dega në Vushtri në Gjykatën Themelore Mitrovicë.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga z. Arbër Beqiri, bashkëpunëtor profesionale në Gjykatën Themelore Mitrovicë dega Vushtri, ka pranuar kërkesë për transfer në Gjykatën Themelore Mitrovicë. Sa i përket arsyeve për të cilat ka kërkuar transferin, e njëjta ka theksuar çështjen e largësisë së vendbanimit të tij nga gjykata ku aktualisht ushtron funksionin e bashkëpunëtorit profesionale.

Këshilli pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së z. Beqiri si dhe me njoftimin se nënkryetari i Gjykatës Themelore Mitrovicë, nuk ka dhënë pëlqim për këtë transfer, ka refuzuar kërkesën e z. Beqiri, duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Arbër Beqiri;
- Z. Bekim Veliqi, nënkryetar i Gjykatës Themelore Mitrovicë;
- Gjyqtarit Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Mitrovicë dega Vushtri;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.